

# VLERËSIMI I KOMUNITETIT PËR QEVERISJEN

RAPORT BASHKIA GJIROKASTËR



# **RAPORT**

**VLERËSIMI I KOMUNITETIT PËR  
QEVERISJEN 2016**

**BASHKIA GJIROKASTËR**

## SHËNIM I RËNDËSISHËM

Ky raport u përgatit me:

Mbështetjen financiare dhe teknike të Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID). Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Dhe me

Mbështetjen financiare dhe teknike të Njesisë së Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women), në kuadër të programit “Lidershipi dhe Pjesëmarrja Politike”. Ky program është financuar nga Qeveria Suedeze nëpërmjet Fondit të Koherencës së Kombeve të Bashkuara dhe është pjesë e “Programit të Bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2012-2016”. Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e UN Women, të Agjencive të Kombeve të Bashkuara apo të Qeverisë Suedeze.

## AUTORËT

Raporti u përgatit dhe u hartua nga ekspertët e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim në bashkëpunim me Dimension Human dhe Gruaja Intelktuale në Gjirokastër me mbështetjen dhe asistencën e:

**Laureta MEMO**, Eksperte për Angazhimin Qytetar dhe Komunikimin, USAID/ Projekti i Planifikimit dhe Qeverisjes Vendore

**Fiorela SHALSI**, Menaxhere e Programit Kombëtar “Lidershipi dhe Pjesëmarrja në Politikë”, UN Women

Të drejtat e publikimit

© Aplikimet për lejen për të riprodhuar ose përkthyer të gjithë ose një pjesë të këtij studimi duhet bërë në zyrën e GADC-së me adresë:

Rr. Abdyl Frashëri”, P.10/1, shk.1, ap.3

E-Mail: [gadc@gadc.org.al](mailto:gadc@gadc.org.al)

[www.gadc.org.al](http://www.gadc.org.al)

# TABELA E PËRMBAJTJES

<b>MIRËNJOHJE</b> .....	<b>5</b>
<b>SHKURTIME</b> .....	<b>6</b>
<b>1. HYRJE</b> .....	<b>7</b>
<b>2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	<b>8</b>
<b>3. PROFILI I BASHKISË GJIROKASTËR</b> .....	<b>9</b>
<b>4. METODOLOGJIA</b> .....	<b>11</b>
<b>5. PËRSHKRIM I PROJEKTIT</b> .....	<b>13</b>
<b>6. PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE</b> .....	<b>15</b>
<b>7. GJETJET KRYESORE</b> .....	<b>17</b>
7.1 CILËSIA DHE EFIÇENCA E SHËRBIMEVE PUBLIKE .....	17
7.2 DEMOKRACIA VENDORE-MIRËQEVERISJA.....	17
7.3 ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR .....	18
7.4 TË DREJTAT E NJERIUT NË NIVEL LOKAL.....	18
<b>8. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME</b> .....	<b>20</b>
8.1 KONKLUSIONE PËR QYTETIN .....	20
8.1.1 SHËRBIMET PUBLIKE – CILËSIA DHE EFIÇENCA .....	20
8.1.2 DEMOKRACIA VENDORE - MIRËQEVERISJA.....	21
8.1.3 ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR .....	21
8.1.4 TË DREJTAT E NJERIUT NË NIVEL LOKAL.....	22
8.2 KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME PËR NJËSITË ADMINISTRATIVE.....	23
8.2.1 SHËRBIMET PUBLIKE - CILËSIA DHE EFIÇENCA .....	23
8.2.2 DEMOKRACIA LOKALE - MIRËQEVERISJA.....	24
8.2.3 ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR .....	25
8.2.4 TË DREJTAT E NJERIUT NË NIVEL VENDOR.....	25
8.3 REKOMANDIME .....	26
<b>RRETH QENDRËS ALEANCA GJINORE PËR ZHVILLIM</b> .....	<b>28</b>

# MIRËNJOHJE

Me mirënjohje falënderojmë të gjithë ata që ndihmuan në realizimin e këtij raporti për të vlerësuar qeverisjen vendore dhe gjithë qytetarët e Bashkisë Gjirokastrë, të cilët morën pjesë aktive në aktivitet e realizuara përmes projektit dhe përmes argumenteve vlerësuan mirëqeverisjen lokale për bashkinë e tyre.

Një falënderim i veçantë i dedikohet znj. Zamira Rami dhe stafit të saj, të cilët morën angazhime konkrete përballë qytetarëve bazuar në sugjerimet e tyre për përmirësimin e punës në Bashkinë e Gjirokastrës.

Një falënderim gjithashtu shkon edhe për mbështetësit dhe financuesit e këtij projekti, Programit të Kombeve të Bashkuara për Gratë në Shqipëri, UN Women dhe Projektit të USAID për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP) për mbështetjen financiare dhe teknike gjatë zbatimit të projektit.

# SHKURTIME

NJQV	Njësi të Qeverisjes Vendore
KKQV	Komisioni Këshillimor Qytetar Vendor
QAGJZH	Qendra “Aleanca Gjimore për Zhvillim”
RAT	Reforma Administrative-Territoriale
VKQ	Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen
UN Women	Programi i Kombeve të Bashkuara për Gratë
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

# 1. HYRJE

Ndërkohë që po bëhet progres për avancimin e procesit të decentralizimit në Shqipëri, sfidat për zbatimin me sukses të qeverisjes vendore të decentralizuar e demokratike janë të mëdha. Reforma Administrative-Territoriale (RAT) që filloi të zbatohet në qershor të vitit 2015, pati ndikim të konsiderueshëm në funksionimin dhe administrimin e njësive të qeverisjes vendore (NJQV). Zvogëlimi i numrit të NJQV-ve nga 373 në 61, çoi rrjedhimisht në rritjen ndjeshëm të territorit, popullsisë dhe kompleksitetit të funksionimit të tyre. Ndikimi i reformës është i madh, jo vetëm në aspektin e përgjegjësive dhe funksioneve të shtuara të njësive vendore, por edhe në ofrimin e shërbimeve me cilësi dhe efikasitet për qytetarët e bashkisë së zgjeruar tashmë. Paralelisht me këtë, bashkitë tani përballen me sfida edhe më të mëdha se më parë për të arritur informimin, përfshirjen dhe përfaqësimin e vërtetë të grave dhe burrave në vendimmarrje.

Në këtë kuadër, që prej vitit 2015, Projekti i USAID për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP) dhe UN Women, në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile dhe Komisionet Këshillimore Qytetare Vendore (KKQV) kanë ndërmarrë projektin e Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen (VKQ) në 10 nga bashkitë më të mëdha në vend. Në pritje të reformës dhe zgjedhjeve vendore të vitit 2015, VKQ u zbatua në bashkitë e Elbasanit, Beratit, Kamzës dhe Vlorës, ku gjetjet dhe rekomandimet e qytetarëve gra dhe burra u prezantuan dhe u përfshinë në axhendat dhe programet e kandidatëve për kryetarë bashkie. Këtë vit, VKQ u zbatua në gjashtë bashki të reja: Fier, Gjirokastrë, Kuçovë, Korçë, Lushnjë dhe Shkodër. Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen përfshin aspekte kryesore të qeverisjes vendore, të tilla si: (I) cilësia dhe efikasiteti i shërbimeve publike; (II) qeverisja e mirë dhe demokracia lokale; (III) zhvillimi ekonomik dhe (IV) të drejtat e njeriut në nivel vendor.

Përmes vjeljes së opinioneve të qytetarëve në identifikimin dhe përcaktimin e prioriteteve lokale, VKQ synon të krijojë dhe promovojë mekanizma qytetare në funksion të përmirësimit të demokracisë lokale. Procesi i VKQ mundëson monitorimin dhe vlerësimin e performancës së administratës lokale, paralelisht me ndërtimin e urave të dialogut, ndërveprimit dhe bashkëpunimit në nivel vendor.

Vlerësimi i komunitetit për qeverisjen është një qasje dhe mundësi e mirë që bashkitë të kuptojnë nevojat dhe përparësitë e qytetarëve. Harmonizimi dhe përfshirja e rezultateve të vlerësimit të komunitetit në programet vendore, si dhe përpjekja për të influencuar në hartimin e politikave vendore, janë një tregues pozitiv i demokracisë në veprim. Kombinimi i metodologjive se VKQ me aktorë kyç lokalë, të tillë si Komisionet Këshillimore Qytetare dhe organizata të shoqërisë civile kanë mundësuar zbatimin me sukses të këtij procesi.

## 2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Informacioni i përfshirë në këtë raport prezanton ecurinë e procesit të Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen në Bashkinë Gjirokastrë dhe përfshin vlerësimin nga ana e komunitetit dhe administratës vendore të performancës së shërbimeve të ofruara në nivel vendor, si dhe gjetjet dhe rekomandimet e ardhura nga qytetarët. Procesi i VKQ-së i ofron Bashkisë Gjirokastrë një tablo të qartë të vlerësimit të qytetarëve në lidhje me shërbimet publike, zhvillimin ekonomik, funksionimin e demokracisë vendore dhe të drejtat e njeriut në nivel lokal.

Procesi i Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen u realizua nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGJZH) në bashkëpunim me Bashkinë Gjirokastrë, njësitë administrative Cepo, Lunxhëri dhe Antigone dhe komunitetit në njësitë administrative të sipërpërmendura.

Projekti Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen u shtri në harkun kohor qershor-nëntor 2016 dhe përfshiu 10 bashki, ndër të cilat edhe Bashkinë Gjirokastrë. Qëllimi i këtij projekti është përmirësimi i demokracisë vendore përmes fuqizimit të mekanizmave qytetarë. Objektiva specifike të tij synojnë të nxisin ndërveprimin dhe dialogun mes qytetarëve dhe autoriteteve vendore, përmes përfshirjes së prioritetëve dhe nevojave të qytetarëve në programet dhe buxhetet vendore, duke krijuar kushte për përmirësime të qëndrueshme të shërbimeve që i ofrohen komunitetit dhe duke fuqizuar në këtë mënyrë bashkëpunimin midis të dyja palëve.

Për realizimin e VKQ u punua ngushtësisht me administratën e bashkisë për të siguruar gatishmërinë dhe bashkëpunimin e tyre në proces, gjë që kërkoi takime dhe diskutime paraprake në lidhje me metodologjinë, fushat që trajtonte VKQ, zonat e përzgjedhura për zbatim dhe pjesëmarrjen qytetare në të. Në bashkërendim me Bashkinë, zonat e zgjedhura për të realizuar VKQ ishin njësitë administrative Cepo, Lunxhëri, Antigone.

Gjatë procesit të përpunimit të vlerësimeve janë konsultuar gjerësisht materiale, dokumente dhe strategji, të tilla si: Draft Strategjia e Zhvillimit të Territorit, buxheti i Bashkisë për vitin 2016, Plani i Punës së Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020, Ligji 119/2014 Për të drejtën e Informimit, Ligji 135/2015 për Organizimin dhe Funksionimin e Vetëqeverisjes Vendore, faqja e internetit e Bashkisë, etj.

Në këtë raport do të lexoni: 1) Një profil të shkurtër të Bashkisë Gjirokastrë; 2) Metodologjinë e projektit; 3) Përshkrimin e projektit; 4) Përmbledhjen e rezultateve të vlerësimit të qytetarëve korçarë për qeverisjen vendore; 5) Gjetje e rekomandime për të ardhmen.



# 3. PROFILI I BASHKISË GJIROKASTËR

Bashkia e Gjirokastrës kufizohet në veri me bashkinë Tepelenë, në lindje me Bashkinë Libohovë, në jug me bashkinë Dropull dhe në perëndim me bashkitë Himarë dhe Delvinë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Gjirokastrës. Sipas Censurit të vitit 2011 bashkia ka një popullsi prej 25.301 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil ajo numëron 52.054 banorë. Bashkia shtrihet në një sipërfaqe prej 469.25 km<sup>2</sup> me një densitet prej 53.91 banorë/km<sup>2</sup> sipas Censurit 2011 dhe 110.93 banorë sipas Regjistrimit Civil. Kjo bashki përbëhet nga 7 njësi administrative, të cilat janë: Gjirokastra, Cepo, Lazarat, Picar, Lunxhëri, Odrie dhe Antigone. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 38 fshatra.

Bashkia e re e Gjirokastrës përbëhet nga qyteti i Gjirokastrës, i cili prej vitit 2005 ndodhet në listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s si dhe zonat rurale kodrinore përreth, të përqendruara më së shumti të prodhimet blegtorale. Gjirokastra është një qytet tregtar i stilit otoman, ndër të paktët të tillë të mbijetuar në Ballkan. Qyteti ka mbi 800 ndërtesa historike, shumë prej të cilave rrezikohen nga degradimi. Katet përdhese të shtëpive karakteristike shërbenin si struktura mbrojtëse edhe depo të shtëpive. Ndërsa katet e sipërme shprehnin mikpritjen gjirokastrite, kulturën dhe mënyrën e jetesës së tyre.

Kostumet lokale të Gjirokastrës janë tradicionalisht të zbukuruar me qëndisma të komplikuar. Po ashtu prodhohen në mënyrë artizanale qilima e velenxa, triko, çorape e doreza. Të famshme në të gjithë vendin janë dantellat e Gjirokastrës; punime me grep dhe qëndisimat. Ndërsa burrat përpunojnë drurin dhe gurin. Veshjet tradicionale popullore të grave zbukuroheshin me fije metalesh të çmuara si kostumet e famshme të grave të Lunxhërisë. Muzika tradicionale polifonike shqiptare ka stilin e saj në Gjirokastrë me interpretime virtuozë të disa gjeneratave, përfshirë sot edhe një grup fëmijësh. E integruar në Iso-Polifoninë shqiptare, ajo është njohur më 2005 nga UNESCO si "*trashëgimi kulturore e paprekshme*". Pjesë e bashkisë së re do të jetë edhe Parku Arkeologjik i Antigonesë-Adrianapol, i cili u krijua në vitin 2005 me një sipërfaqe prej 92 hektarësh.

Burimet kryesore të ekonomisë urbane në Gjirokastrë janë turizmi dhe manufaktura me material porositës, e cila shërben përgjithësisht për tregun grek dhe që gjatë viteve të fundit është goditur rëndë për shkak të krizës në Greqi. Gjirokastra është gjithashtu qytet me aktivitete të konsiderueshëm tregtar, veçanërisht sa i përket importeve nga Greqia. Zona rurale që i bashkëngjitet qytetit është e njohur për blegtorinë e imtë dhe për produktet blegtorale shumë cilësore.

Gjirokastra është zona më e prekur në Shqipëri nga emigrimi masiv i popullsisë përgjatë dy dekadave të fundit, gjë që ka sjellë edhe plakjen e shpejtë të popullsisë. Sipas regjistrimit të popullsisë 2011, qarku i Gjirokastrës ka moshën mesatare më të lartë në Shqipëri me gati 40 vjeç.

Turizmi në qytetin e Gjirokastrës ka shënuar një hov cilësor gjatë viteve të fundit. Megjithatë, përballë bashkisë së re shtrihet nevoja e përmirësimit të kapaciteteve për promovimin dhe administrimin e turizmit si dhe për zgjatjen e sezonit turistik përtej muajve të pranverës dhe vjeshtës. Qyteti numëron rreth 50-60 mijë vizitorë të huaj në vit si dhe zotëron një rrjet hotelesh që e përballojnë këtë fluks. Bashkia ka një zyrë informimi turistik, por pak produkte promocionale. Zhvillimi i mëtejshëm i artizanatit, i produkteve tradicionale ushqimore dhe i gastronomisë konsiderohet një çështje që kërkon vëmendjen e vazhdueshme të autoriteteve vendore.

Me financime të Bashkisë apo me mbështetjen e Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, në Gjirokastrë po realizohen disa ndërhyrje të rëndësishme në përmirësimin e infrastrukturës si: rikonstrukcioni i Parkut të Viroit, projekti për rrugën hyrëse nga krahu verior (përfshi një korsi për biçikleta dhe këmbësorët) apo shtrimi i rrugëve me kalldrëm në qendrën historike. Megjithatë, Bashkia e re do të duhet të zgjidhë problemin e betonizimit në lagjen 18 Shtatori dhe mungesën e infrastrukturës arsimore në këtë lagje, ku ekziston vetëm një shkollë e mbingarkuar me nxënës.

Transporti i nxënësve në të gjitha shkollat e bashkisë së re konsiderohet një tjetër çështje që kërkon zgjidhje, pasi shpopullimi i shumë zonave ka sjellë mbylljen e shkollave në fshatave dhe rritjen e distancave për fëmijët.

Furnizimi me ujë të pijshëm pritet ndërkohë të zgjidhet përfundimisht pas përfundimit të rikonstruktimit të ujësjellësit, i cili përfshin gjenerimin e rrjetit të vjetër si dhe ndërtim deposh të reja.

Bashkia pritet të prokurojë një financim për zgjerimin e korsisë rrugore nga rruga kombëtare në hyrjen jugore në sheshin kryesor të Qendrës Historike. Parashikohet ngritja e një parkingu dhe mobilime të tjera urbane, të cilat synojnë kthimin e zonës së Pazarit të vjetër në një zonë këmbësorësh gjatë sezonit turistik maj-tetor.

# 4. METODOLOGJIA

Procesi i Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen<sup>1</sup> është mjet monitorimi që përdor komunitetin si njësi analize për të nxitur llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë sociale dhe publike të institucioneve vendimmarrëse vendore. Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen njihet ndryshe edhe si “zëri i komunitetit”, pasi i mundëson qytetarëve të shprehin vlerësimin e tyre mbi cilësinë, përshtatshmërinë dhe efikasitetin e shërbimeve publike dhe të propozojë ndryshime në lidhje me shërbimet e ofruara, madje edhe mbi vendimmarrjet vendore. Mekanizmi i VKQ-së zbatohet në një nivel teje të rëndësishëm të qeverisjes, në atë vendor, ku qytetarët janë në kontakt më të drejtpërdrejtë me autoritetet vendimmarrëse dhe mbi të gjitha, me shërbimet e ofruara prej tyre.

Procesi mundëson krijimin e dialogut mes komunitetit dhe autoriteteve vendore, duke përballur mundësitë (burimet që kanë në dispozicion autoritetet vendore) me nevojat reale të komunitetit. Zbatimi i këtij mekanizmi në nivelin vendor ndikon në: zhvillimin e demokracisë me pjesëmarrje dhe arritjen e mirëqeverisjes vendore. Duhet të theksojmë gjithashtu se VKQ-ja nuk është thjesht një proces vlerësimi, pasi shkon përtej tij. Ajo ndërton ndërveprimin mes komunitetit, autoriteteve vendore, organizatave të shoqërisë civile etj, duke krijuar kushte për përmirësime të qëndrueshme të shërbimeve që i ofrohen komunitetit, duke e fuqizuar atë.

**Gjatë procesit të VKQ-së parimet kryesore të vlerësimit të shërbimit (pavarësisht nga çështja objekt i VKQ-së) do janë:**

- **Përshtatshmëria:** programi apo shërbimi a i reflekton nevojat e grupit të targetuar? A i respekton standardet dhe kriteret që përcakton ligji?
- **Efiçenca:** A po përdoren burimet (financiare, njerëzore, lokale) në mënyrë efektive dhe në kohën e duhur? A përfshihet komuniteti në planifikimin e këtyre bulimeve?
- **Pjesëmarrja:** Sa dhe si nxitet pjesëmarrja e komunitetit në planifikimin dhe zbatimin e programit/shërbimeve? Cilat janë metodat që përdorin autoritetet për të nxitur pjesëmarrjen?
- **Qëndrueshmëria:** jetëgjatësia e programeve, shërbimeve. A janë fondet vjetore në rritje apo ato nuk ekzistojnë?
- **Rezultati:** Çfarë ndryshimesh ka sjellë zbatimi i programit/shërbimit? Çfarë rrugësh përdorin autoritetet për të matur ndikimin?

Përfituesit e Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen janë komuniteti dhe autoritet vendore. **Procesi i VKQ-së i mundëson komunitetit** të informohet mbi shërbimet që ofrohen nga autoritetet vendore; të shprehë opinionin e tij mbi cilësinë dhe efikasitetin e tyre; të monitorojë përmbushjen e detyrimeve/angazhimeve e tyre në ofrimin e shërbimeve cilësore; të shprehë drejtpërdrejtë tek autoritetet përkatëse opinionin e tij dhe t'u kërkojë atyre përmirësimet e

---

<sup>1</sup> Marrë nga Manuali për Shoqërinë Civile “Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen”- Mbështetur nga Njësia e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Eomen), Shtëpia Botuese IDEART, 2012 Tiranë

nevojshme, si dhe të ndërveprojë me autoritetet përkatëse me qëllim përfitim të shërbimeve cilësore e të qëndrueshme. **VKQ i jep mundësinë autoriteteve vendore** të njohin më mirë nevojat dhe prioritetet e komunitetit në përgjithësi, si dhe të grupeve të veçanta të tij; të orientojnë më mirë burimet që kanë në dispozicion në përputhje me këto nevoja dhe prioritetet e komunitetit, të rrisin kapacitetet e tyre, transparencën në qeverisje dhe të përmirësojnë cilësinë dhe përshtatshmërinë e shërbimeve që i ofrojnë komunitetit.

Procesi i Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen realizohet përmes disa etapave, të tilla si: (1) Vlerësimi për ndjekjen e të dhënave (gjetja dhe konsultimi i dokumenteve, materialeve dhe strategjive që lidhen me Bashkinë); (II) Vlerësimi komunitar për performancën (fokus grupe me qytetare të Bashkisë në zonën urbane dhe rurale); (III) Vlerësimi ose vetë-vlerësimi nga ofruesit e shërbimeve (intervista gjysme të strukturuar me autoritetet lokale); (IV) Takimi i drejtpërdrejt midis përfituesve dhe ofruesve (prezantim publik i gjetjeve dhe rekomandimeve nga ky proces dhe (V) Përgatitja e raportit me qëllim institucionalizimin e procesin, advokimin dhe monitorimin.

# 5. PËRSHKRIM I PROJEKTIT

Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen kaloi në disa faza, të cilat janë të detajuara si më poshtë:

**Skedat e vlerësimit:** Faza përgatitore e projektit ishte shumë e rëndësishme për përcaktimin e aspekteve/fushave që do të mbulonte dhe treguesve që do të përmbante VKQ. Katër fushat e përzgjedhura ishin: (I) cilësia dhe efienca e shërbimeve publike, (II) qeverisja e mirë dhe demokracia lokale, (III) zhvillimi ekonomik dhe (IV) të drejtat e njeriut në nivel vendor. Bazuar në to u përcaktuan edhe 20 treguesit e performancës. U përgatitën tre lloje skedash specifike për qytetin, njësinë administrative dhe një përmbledhëse me vlerësimin e qytetareve dhe ofruesve të shërbimeve. Treguesit që u përdorën për Vlerësimin e Komunitetit për Qeverisjen janë:

## SHËRBIMET PUBLIKE

Rrugët  
Ndriçimi  
Pastrimi  
Gjelbërimi  
Uji i pishëm & kanalizimet

## DEMOKRACIA VENDORE/ MIRËQEVERISJA

Informimi dhe komunikimi  
Transparenca  
Pjesëmarrja në vendimmarrje

## ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR






Planifikimi strategjik  
Planifikimi i buxhetit  
Nxitja e bizneseve  
Nxitja e punësimit  
me fokus të veçantë gratë e të rinjtë

## TË DREJTAT E NJERIUT NË NIVEL LOKAL

Gratë  
Grupet me nevoja të veçanta  
Romët/egjiptianët  
Mbrojtja nga Diskriminimi

**Fokus grupet:** Me synimin e marrjes së mendimit qytetar në muajin korrik u organizuan 5 fokus grupe me përfaqësues të komunitetit dhe banorë të qytetit Gjirokastër dhe njësive administrative Cepo, Lunxhëri dhe Antigone. Në takime morën pjesë 80 pjesëmarrës (përfaqësues të OJQ, individë komunitarë që përfaqësonin grupe të marginalizuara, qytetarë aktivë, kryepleq fshatrash) të cilët me anë të pikëzimit vlerësuan performancën e bashkisë dhe identifikuan nevojat dhe prioritetet e qytetarëve. Në vlerësimin e komunitetit për qeverisjen procesi pati pjesëmarrje të balancuar gjinore meshkuj dhe femra. Gjatë realizimit të fokus grupeve me komunitetin, pjesëmarrësit u prezantuan me qëllimin dhe objektivat e projektit, informacione mbi zbatimin e Reformës Administrative-Territoriale, ndryshimi i kuadrit ligjor dhe mekanizmat që mbështesin pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje.

**Intervista gjysmë të strukturuar:** Pas takimit me qytetarët u organizuan intervista gjysmë të strukturuar me përfaqësues të Bashkisë, ku u ofruesit e shërbimeve vetë-vlerësuan përmes sistemit të pikëzimit shërbimet që ata ofrojnë për komunitetin. Intervistat përfshinë Kryetaren e Bashkisë, drejtorinë e shërbimeve sociale, drejtorinë e projekteve dhe administratorët e njësive Cepo, Lunxhëri, Antigone. Shkalla e vlerësimit sipas pikëzimit që u përdor në Vlerësimin e Komunitetit për Qeverisjen si me qytetarët, ashtu edhe me bashkinë është si më poshtë:

Kriteret		Pikëzimi
Nuk ofrohet shërbim ose cilësia është shumë e dobët		1-Shumë keq
Shërbimi ofrohet, por cilësia është e dobët		2- Keq
Shërbimi ofrohet dhe është relativisht i mirë		3- Çka (mesatar)
Shërbimi ofrohet me cilësi të mirë		4- Mirë
Shërbimi ofrohet me cilësi të lartë		5- Shumë mirë

**Analizimi i të dhënave:** Moment shumë i rëndësishëm i VKQ është hedhja dhe analizimi i të dhënave nga fokus grupet dhe intervistat me ofruesit e shërbimeve. Gjatë kësaj faze është bërë edhe konsolidimi në një skedë i pikëzimit dhe gjetjeve nga qytetarët dhe ofruesit e shërbimeve. Pjesë thelbësore e punës ishte edhe konsultimi me dokumente/strategji dhe informacione të tjera që jepnin një ide me të qartë të fushave dhe treguesve të analizuar.

**Prezantimi publik:** Faza e fundit e VKQ në Bashkinë Gjirokastrë ishte prezantimi publik i procesit të vlerësimit. Ai u organizua në formën e një forumi publik me qytetarët e Gjirokastrës. Përveç Kryetares së bashkisë dhe stafit të saj, në takim morën pjesë edhe përfaqësues të OJQ-ve që veprojnë në Gjirokastrë, individë komunitarë që përfaqësonin grupe të marginalizuara, qytetarë aktivë, administratorë e kryepleq fshatrash të cilët morën pjesë në fokus grupet e organizuara. Takimi përfshiu një prezantim të gjetjeve nga ky proces, dhe në fund u ofruan rekomandimet që dolën nga takimet me qytetarët. Kryetarja e Bashkisë vlerësoi procesin si një mundësi e mirë për të marr mendimin e qytetarëve dhe si një formë e mirë për të rritur bashkëpunimin dhe dialogun me ta në të ardhmen. Rekomandimet do të merren parasysh në hartimin e buxhetit të vitit pasardhës, si dhe do të bëhen pjesë e Planit Strategjik të Territorit që është në proces hartimi.

# 6. PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE

Siç u shpjegua më sipër në raport, në procesin e Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen u përfshinë qytetarët e njësisë administrative qendër Gjirokastrë dhe njësive administrative Cepo, Lunxhëri dhe Antigone. Paralelisht me ta u intervistuan edhe punonjësit e bashkisë/ofruesit e shërbimeve. Sipas shpjegimit të mësipërm, për procesin e vlerësimit u përdor sistemi i pikëzimit nga 1 në 5. Më poshtë keni rezultatet e dala dhe analizuara nga ky vlerësim.

- a) **Cilësia dhe efiçenca e shërbimeve publike** - rrugë/ trotuare, ndriçim, pastrim, gjelbërim, furnizim me ujë të pijshëm dhe kanalizime, kanalet kulluese e vaditëse, pyjet e kullotat

CILËSIA DHE EFIÇENCA E SHËRBIMEVE PUBLIKE		
	TË INTERVISTUARIT	PIKËZIMI
QYTET	Qytetarët	3
	Ofruesit e shërbimeve	4
NJËSI ADMINISTRATIVE	Qytetarët	2.5
	Ofruesit e shërbimeve	3.5

- b) **Demokracia vendore – mirëqeverisja** – informimi dhe komunikimi, transparenca në vendimmarrje, pjesëmarrja në vendimmarrje

DEMOKRACIA VENDORE – MIRËQEVERISJA		
	TË INTERVISTUARIT	PIKËZIMI
QYTET	Qytetarët	3.5
	Ofruesit e shërbimeve	4.6
NJËSI ADMINISTRATIVE	Qytetarët	3
	Ofruesit e shërbimeve	4

- c) **Zhvillimi ekonomik vendor** - planifikimi strategjik, nxitja e biznesit, nxitja e punësimit, mbledhja e të ardhurave dhe planifikimi i buxhetit

<b>ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR</b>		
	<b>TË INTERVISTUARIT</b>	<b>PIKËZIMI</b>
<b>QYTET</b>	Qytetarët	<b>2.5</b>
	Ofruesit e shërbimeve	<b>3.5</b>
<b>NJËSI ADMINISTRATIVE</b>	Qytetarët	<b>1.8</b>
	Ofruesit e shërbimeve	<b>3</b>

- d) **Të drejtat e njeriut në nivel lokal** - gratë, grupe me nevoja të veçanta, romët dhe egjiptianët, mbrojtja nga diskriminimi

<b>TË DREJTAT E NJERIUT NË NIVEL LOKAL</b>		
	<b>TË INTERVISTUARIT</b>	<b>PIKËZIMI</b>
<b>QYTET</b>	Qytetarët	<b>3</b>
	Ofruesit e shërbimeve	<b>3.5</b>
<b>NJËSI ADMINISTRATIVE</b>	Qytetarët	<b>2.5</b>
	Ofruesit e shërbimeve	<b>3.5</b>

Përveç sistemit të pikëzimit pjesëmarrësit në vlerësim patën mundësinë të jepnin edhe komente e sugjerime/rekomandime. Më poshtë po rendisim disa prej gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore, që qytetarët dhe ofruesit e shërbimeve kanë bërë në Bashkinë Gjirokastrë.



# 7. GJETJET KRYESORE

Ky vështrim krahasues ndihmon për të kuptuar më qartë diferencat në shërbimet që ofrohen për banorët në territore të ndryshme të bashkisë. Procesi i vlerësimit ka treguar se diferencat aktuale mes zonës urbane dhe rurale brenda territorit të bashkisë vijnë në një masë të konsiderueshme nga mungesa e investimeve në ish-komunat në periudhën përpara reformës territoriale, por gjithsesi janë diferenca që duhet të adresohen në respekt të të drejtës së qytetarëve për të marrë të njëjtat shërbime pavarësisht zonës ku banojnë. Nga krahasimi i vlerësimeve të kryera nga komuniteti në zonën urbane kundrejt zonës rurale rezulton:

## 7.1 Cilësia dhe efienca e shërbimeve publike

Ka një diferencë të dukshme të vlerësimit të qytetarëve të përfshirë në procesin e VKQ-së për **cilësinë e rrugëve dhe trotuareve** si brenda Bashkisë, ashtu edhe midis bashkisë dhe njësive administrative përbërëse të saj. Dukshëm cilësia e rrugëve dhe trotuareve është vlerësuar më mirë në zonat kryesore të qytetit; është vlerësuar më pak në zonën periferike të vetë qytetit në dhe shumë më pak në zonat rurale të njësive administrative. Dy vitet e fundit janë bërë investime të shumta në infrastrukturën rrugore si edhe mbjelljen e fidanëve të rinj në brendësi të qytetit. Gjithashtu, është punuar edhe për të përshtatur trotualet e rinj dhe ekzistues për nevojat e personave me aftësi të kufizuar.

E njëjta diferencë në vlerësim vihet re edhe tek **ndriçimi dhe pastrimi** ku raportohet situatë e mirë në zonën qendrore dhe problematike në periferi dhe rrugë dytësore.

**Furnizimi me ujë të pijshëm** rezulton problematik për të gjitha njësitë e përfshira në vlerësim. Linjat e shpërndarjes janë të amortizuara. Mosfurnizimi me ujë gjatë gjithë ditës rrit shpenzimet e konsumatorëve pasi janë të detyruar të përdorin pompa e depozita për të pasur ujë në shtëpitë e tyre. Në zonën e qytetit raportohen shpime të paligjshme për furnizim me ujë, si dhe përdorim i ujit të pijshëm për vaditje apo në lavazhe.

Në të tre njësitë Cepo, Lunxhëri dhe Antigone, komuniteti i përfshirë në vlerësim është shprehur i pakënaqur për bllokimin e vazhdueshëm të **kanaleve kulluese**, ku ndërhyrjet për pastrim nuk janë të vazhdueshme por vetëm në periudhën e shirave. Po ashtu, zonat e dëmtuara nga erozioni kanë nevojë për ndërhyrje.

## 7.2 Demokracia vendore-mirëqeverisja

E përbashkëta e zonës urbane me zonën rurale në këndvështrimin e **informimit dhe komunikimit me autoritetet vendore** qëndron të faktin se në të dy rastet, komuniteti ka akses në informacion. Në zonën urbane përdorej më shumë interneti kurse në zonën rurale burimi kryesor i informacionit janë tabelat në qendrat e njësive administrative, letra informuese të ngjitura dukshëm në qendrat/ rrugët kryesore të fshatrave apo takimet informale duke

shfrytëzuar njohjet personale me nëpunësit e njësive administrative. Edhe brenda zonës urbane ka diferenca mes qendrës dhe periferisë.

Të gjitha fokus grupet treguan që pjesëmarrësit ishin në dijeni që Bashkia organizonte takime me komunitetin, si një **formë që nxiste përfshirjen e mendimit të tyre në vendimmarrje**. Ndryshe nga qendra e zonës urbane ku një pjesë e pjesëmarrësve u shprehën se ishin njoftuar/kishin marrë pjesë në takime të tilla, të gjithë pjesëmarrësit pohuan se ata nuk ishin njoftuar asnjëherë për ndonjë takim që mund të ketë organizuar bashkia e nuk iu është dhënë mundësia të ngrenë problemet e komunitetit të tyre në ndonjë mbledhje të tillë. E vetmja mënyre që banorët e njësive administrative në zonat rurale adresojnë problemet e tyre është përmes ankesave të depozituara pranë njësisë administrative apo bashkinë qendër qofte në mënyrë personale apo edhe në grupe të vogla.

### 7.3 Zhvillimi Ekonomik Vendor

Ka një mungesë informimi të gjerë në lidhje me **ekzistencën e planit strategjik për zhvillimin ekonomik** dhe akoma më shumë me çfarë parashikon ky plan për secilën prej tre njësive administrative objekt i këtij vlerësimi, sikurse dhe për zonën periferike të Bashkisë Gjirokastrë, ndryshe nga fokus grupi në lagjet qendër qyteti që ishin në dijeni si të ekzistencës së planit, sikurse kishin marrë pjesë në dëgjesa publike të organizuara nga Bashkia për këtë qëllim.

Pjesëmarrësit në të gjitha fokus grupet (si në qendër edhe periferi edhe njësitë administrative) **nuk ishin në dijeni të ndonjë strategjie, politike apo plani të Bashkisë për nxitjen e biznesit privat**. Gjithsesi pjesëmarrësit në vlerësimin në qendër të Bashkisë u shprehën se është lehtësuar taksat për gratë dhe ka një ndjeshmëri më të madhe për to për t'i inkurajuar në hapjen e bizneseve.

Në të gjitha fokus grupet pjesëmarrësit raportuan të njëjtën formë të njoftimit për detyrimin për taksat nga Bashkia: faturat që shkojnë në banesa dhe të njëjtën formë detyrimi për t'i paguar: mosdhënien e certifikatave në rast mos pagimi. **Banorët e qytetit dhe të zonave rurale u shprehën se taksat paguhen në nivele të kënaqshme edhe si rezultat i sanksioneve të vendosura nga bashkia.**

### 7.4 Të drejtat e njeriut në nivel lokal

**Dukshëm ka mungesë informimi të banorëve të zonave rurale mbi aktivitetin e Bashkisë në këndvështrimin e adresimit të dhunës me bazë gjinore.** Ndryshe nga zona urbane, shumica e pjesëmarrësve në fokus grup në Lunxhëri dhe Cepo e Antigone nuk ishin në dijeni të ekzistencës së programeve të Bashkisë për adresimin e dhunës me bazë gjinore, si dhe nuk ishin në dijeni të fushatave të ndërgjegjësimit të ndërmarra për këtë çështje. Gratë dhe vajzat pjesëmarrëse në fokus grupe pohuan se ato nuk kishin marrë asnjëherë pjesë në trajnime apo takime sensibilizuese me tematikë si “dhuna në familje, barazia gjinore dhe të drejtat e njeriut”. Duket se aktiviteti i Zyrës për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje në bashkinë Gjirokastrë ka ende shtrirje gjeografike të kufizuara.

Në lidhje me ekzistencën e programeve të **veçanta për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të grupeve me nevoja të veçanta** pjesëmarrësit në fokus grupin pohuan se i vetmi

program që ata njihnin ishte ai i mbështetjes sociale (ndihma ekonomike dhe e paaftësisë) të familjeve të varfra apo atyre me nevoja të veçanta me fonde të qeverisjes qendrore.

Ndryshe nga pjesëmarrësit e fokus grupit në lagjet qendër të Bashkisë Gjirokastrë që e dinin se Bashkia ka program të veçantë për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të romëve dhe egjiptianëve e madje bashkëpunon me disa shoqata për këtë qëllim, banorët e njësive administrative nuk kishin informacion për këtë grup

E njëjta situatë në lidhje me **mbrojtjen nga diskriminimi**. Banoret ishin në dijeni të ekzistencës së ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi por pohojnë se nuk kane njohje të programeve nga ana e Bashkisë gjithashtu dhe mungesa e informacionit në lidhje me strukturat e veçanta në njësinë vendore për adresimin e problemeve të ndryshme.

Banorët e qendrës pohojnë se Bashkia ka një zyrë që adreson çështjet që lidhen me mbrojtjen nga diskriminimi, si pjesë e drejtorisë së shërbimeve sociale si dhe një program specifik në përputhje me ligjin respektiv, ndërsa periferia dhe njësitë nuk ishin në dijeni të ekzistencës së ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe as të ndonjë programi të ndërmarrë nga Bashkia për këtë qëllim.

# 8. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

## 8.1 KONKLUSIONE PËR QYTETIN

### 8.1.1 Shërbimet Publike – Cilësia dhe Efiçenca

#### **Rrugët dhe trotuaret**

Në Gjirokastrë ka një përmirësim të dukshëm të ndërhyrjeve në infrastrukturën rrugore. Janë ndërtuar shumë rrugë, megjithatë qytetarët e përfshirë në procesin e VKQ-së kanë vlerësuar se cilësia e tyre, veçanërisht në zonat periferike të qytetit nuk ka qenë në nivelin e standardit të kërkuar. Problemi i cilësisë jo të mirë është evident më tepër në rrugët periferike. Sipas qytetarëve vihen re prishje të rrugës, pusetave, trotuareve dhe heqje e kapakëve të pusetave. Ata e lidhin këtë situatë me cilësinë e punës së supervisorëve dhe mungesës së kontrolleve e mirëmbajtjes pas ndërtimit të rrugëve. Në Gjirokastrë ka sinjalistikë horizontale dhe vertikale sidomos në rrugët kryesore. Ka probleme, ku pas shirave ka rënie të gurëve në rrugë. Pavarësisht se rruga është rregulluar trotuaret kanë filluar të prishen. Rrugët kryesore janë në gjendje të mirë. Nuk mirëmbahen rrugët dytësore, disa rrugë janë ende të paasfaltuara, në mënyrë të veçantë sheshet mes pallateve janë të pasistemuara e të paasfaltuara.

#### **Ndriçimi dhe cilësia e shërbimit**

Në qendër ka ndriçim të rrugëve, por mungojnë në disa rrugë periferike dhe dytësore. Kur prishen ose digjen llambat shpesh rregullohen me vonesë ose nuk rregullohen fare. Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për të mirëmbajtur dhe të për të mos dëmtuar investimet e bëra është shumë e nevojshme.

#### **Pastrimi dhe cilësia e shërbimit**

Pastrimi është më i mirë në qendër, ka mangësi në zonat periferike. Kërkohe shtimi i sasisë së koshave. Pastrueset mbeturinat i hedhin në puseta duke u bërë shkak për bllokimin e pusetave gjatë shiut. Në lagjet periferike ka dalje të ujërave të zeza që prishin pastërtinë e ambientit dhe bëhen shkaktare epidemish.

#### **Gjelbërimi**

Në dy vitet e fundit është rritur sipërfaqja e gjelbëruar në qytet. Prej fundit të vitit 2015, janë shtuar dhjetëra fidanë të rinj në të gjithë gjatësinë e rrugëve të ndryshme por edhe në territorin e njësisive administrative. Megjithatë banorët vlerësojnë se mbetet shumë për t'u bërë në këtë drejtim në të ardhmen.

### **Uji i pijshëm dhe kanalizimet**

Qyteti furnizohet me ujë të pijshëm, por zonat periferike vuajnë. Furnizimi me ujë të pijshëm është me orar. Në lidhje me kanalizimet, bashkia ka bërë disa investime në rrjetin e ujërave të zeza në qytet.

## **8.1.2 Demokracia Vendore - Mirëqeverisja**

### **Informimi dhe komunikimi**

Pjesëmarrësit në fokus grup mendonin se kishin akses në informacionin zyrtar të Bashkisë. Të dhënat që kërkonin i merrnin me lehtësi, kryesisht përmes kërkesës së drejtpërdrejtë në bashki. Mendonin se informacioni i dhënë ishte i qartë dhe i kuptueshëm.

### **Transparenca në vendimmarrje**

Pjesëmarrësit në fokus grup ishin në dijeni të ekzistencës së një faqeje në internet të Bashkisë Gjirokastër, si dhe njoftimet bëheshin publike në hollin e bashkisë. Ata mendonin se njoftimet për mbledhjen e këshillit bashkiak duhet të bëheshin shumë kohë më parë datës së mbledhjes. Gjithashtu, burim i rëndësishëm informacioni ishte media lokale.

Faqja ekzistuese zyrtare në internet e Bashkisë Gjirokastër nuk ka informacion mbi aktivitetin e Bashkisë. Kjo faqe është krijuar dhe përditësohet nga Organizata për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Gjirokastrës, me mbështetjen e Packard Humanities Institute. Si e tillë, nuk kryen funksion informimi dhe transparence.

### **Pjesëmarrja në vendimmarrje**

Nga fokus grupi i zhvilluar arrihet në përfundimin se bashkia përdor forma të ndryshme për të informuar për takime publike: media sociale (facebook), e-mail, median e shkruar, median lokale dhe ftesa. Disa nga qytetarët kanë marrë pjesë në takimet e Bashkisë, por më shumë shoqëria civile. Pjesëmarrësit mendonin se opinionet e shprehura në këto dëgjesa/takime nuk janë mbajtur shumë në konsideratë nga bashkia dhe kjo ka nxitur në vijim indiferentizmin e qytetarëve.

Shumica e pjesëmarrësve në fokus grup deklaruan se nuk lajmërohen për takime publike që organizon Bashkia dhe se vetëm shoqëria civile është më e informuar për aktivitetet e bashkisë. Qytetarët mendonin se duhen lajmërime edhe nëpër lagje ku të ketë kënde informacioni e lajmërimesh. Ishin në dijeni që mbledhjet e këshillave janë të hapura për qytetarët, por nuk kanë interes t'i ndjekin.

## **8.1.3 ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR**

### **Planifikimi strategjik**

Ka pasur plan strategjik për zhvillimin për qytetin dhe është në proces përgatitje një plan zhvillimi që përfshin të gjithë territorin e plotë të kësaj bashkie. Disa nga pjesëmarrësit në fokus grup u shprehën se ishin në dijeni të programit, pasi kishin marrë pjesë në dëgjesa publike. Vetëm një pjesë e pjesëmarrësve në fokus grup ishin në dijeni të ekzistencës së një plani

strategjik të bashkisë për zhvillimin ekonomik. Pjesëmarrësit mendonin se planet me ndikimin në komunitete janë të pakta.

### **Nxitja e bizneseve**

Pjesëmarrësit në fokus grup mendonin se nuk ka politika të mirëfillta sidomos për nxitjen e biznesit familjar. Nga 8 prioritete që ka bashkia, nxitja e biznesit privat është e renditur e gjashta. Inkubatorët e biznesit janë jo ekzistente. Nuk ka një zyrë konsultimi që të orientojë bizneset. Është lehtësuar taksat për gratë dhe ka një ndjeshmëri më të madhe për to për ti inkurajuar në hapjen e bizneseve. Mungon pika informimit e turizmit për Gjirokastrën. Pjesëmarrësit në fokus grup nuk ishin në dijeni të ndonjë strategjie, politike apo plani të bashkisë për nxitjen e biznesit privat, sidomos në lagjet e tyre nuk kanë ndjerë ekzistencën e ndonjëres prej tyre. Nuk ishin në dijeni të shërbimeve që bashkia ofron për bizneset lokale. Ata mendonin se nevojat e grave për punësim janë të mëdha sidomos në lagjet periferike, por nuk kanë ndihmë nga bashkia.

### **Nxitja e punësimit**

Pjesëmarrësit në fokus grup mendojnë se të rinjtë dhe gratë vuajnë më së shumti nga papunësia. Ata vlerësojnë se ka filluar një klimë e re në lidhje me punësimin dhe se po bëhen përpjekje, por e shohin të lidhur me përpjekjet e Zyrës së Punës dhe kurset profesionale. Nuk janë të informuar mbi ekzistencën e strukturave të vetë bashkisë të fokusuar në çështjet e punësimit, apo për ekzistencën e programeve në këtë drejtim.

### **Mbledhja e të ardhurave dhe planifikimi i buxhetit**

Pjesëmarrësit në fokus grup pohuan se njoftohen nga bashkia për detyrimin e tarifave dhe taksave vendore nëpërmjet faturave që shkojnë në banesa. Taksat përgjithësisht paguhen në nivele të kënaqshme por mbetet për t'u diskutuar mënyra se si të ardhurat e mbledhura adresohen për nevojat e komunitetit. Pjesëmarrësit në fokus grup u shprehën të bindur se ata duhet të thirren në takime në mënyrë të vazhdueshme, dhe jo vetëm në periudha elektorale.

## **8.1.4 TË DREJTAT E NJERIUT NË NIVEL LOKAL**

### **Gratë**

Mekanizmi i referimit kundër dhunës në familje është funksional. Ai realizon takime një herë në 3 muaj dhe gjithmonë në raste emergjente por policia ende nuk njofton rregullisht koordinatorin e dhunës në familje dhe për barazinë gjinore. Në muajin Mars 2016, u miratua struktura e re e cila shkëputi zyrën e barazisë gjinore dhe dhunës në familje dhe tani funksionon si grup pune më vete pranë shërbimit social në Bashki. Është vendosur numër telefoni 24 orë për të denoncuar rastet e dhunës. Gjithashtu, gjatë vitit 2016 janë organizuar takime lidhur me efektivitetin e punës me edukatorët e të gjitha kopshteve në qytet, takime nëpër kopshte, shkolla dhe çerdhe për t'i njohur me stafin që punon në zyrën e barazisë gjinore. Stafi i zyrës për barazinë gjinore ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme të iniciuara nga institucione shtetërore, organizata joqeveritare kombëtare dhe ndërkombëtare. Është publikuar numri i tel i NJMF i hapur 24 orë për denoncime në rastet e abuzimit me fëmijët. Me gjithë hapat pozitive të ndërmarrë, ende nuk ka strehëz për gratë e dhunuara.

Pjesëmarrësit u shprehën se ka programe për dhunën ndaj gruas, por më shumë nga shoqëria civile se sa nga Bashkia. Pjesëmarrësit u shprehën se Bashkia duket më e angazhuar për çështjet e dhunës ndaj gruas sepse bashkëpunon me shoqërinë civile dhe për pjesëmarrjen e gruas në politikë, pasi në administratën e Bashkisë ka shumë gra nëpunëse.

### **Grupe me nevoja të veçanta**

Komuniteti i përfshirë në fokus grup nuk ishte dijeni të ekzistencës së një programi të veçantë për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të këtij grupi, si dhe përfshirjen sociale të tij. Bashkia bashkëpunon me shoqatat “Fondacioni Nemia” dhe “Vatra e ngrohtë” për të asistuar grupet në nevojë në raste emergjencash.

### **Romët dhe Egjiptianët**

Bashkia ka program të veçantë për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të këtij grupi, si dhe për përfshirjen sociale. Ajo bashkëpunon ngushtë në nivel institucional me organizata të shoqërisë civile që kanë në fokus komunitetin Rom dhe Egjiptian.

### **Mbrojtja nga diskriminimi**

Bashkia ka një zyrë që adreson çështjet që lidhen me mbrojtjen nga diskriminimi, si pjesë e drejtorisë së shërbimeve sociale si dhe një program specifik në përputhje me ligjin respektiv. Po bëhen përpjekje në këtë fushë.

Shumica e pjesëmarrësve në fokus grup nuk ishin në dijeni të ekzistencës së ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe as të ndonjë programi të ndërmarrë nga Bashkia për këtë qëllim.

## **8.2 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME PËR NJËSITË ADMINISTRATIVE**

### **8.2.1 Shërbimet Publike - Cilësia dhe Efiçenca**

#### **Rrugët dhe trotuaret**

Infrastruktura rrugore në njësinë administrative Lunxhëri vlerësohet e përmirësuar. Pjesa më e madhe e rrugëve lidhëse me qendrat e fshatrave të mëdha janë të asfaltuara ndërkohë që është e nevojshme ndërhyrja në rrugët e tjera dhe në mirëmbajtjen intensive të të gjithë rrjetit rrugor sekondar. Nga ana tjetër, rrugët lidhëse me Njësitë e tjera administrative dhe Bashkinë Gjirokastrë janë ende të papërfunduara gjë që vështirëson komunikimin. Gjithashtu, problematike evidentohet sinjalistika rrugore e cila pothuajse mungon në të gjithë infrastrukturën rrugore. Banorët shtuan se sinjalistika ekzistuese është dëmtuar nga vetë banorët duke nxjerr në pah edhe rolin e rëndësishëm të komunitetit në ruajtjen e pronës publike, një kulture e munguar në përgjithësi në të gjithë vendin. Pjesëmarrësit u shprehën se nuk ka linja të transportit publik që të mbulojnë të gjitha fshatrat (p.sh., fshatrat Karjan, Qestorat, Kakoz dhe Gjat). Bashkia duhet të stimulojë sipërmarrësit duke ndjekur praktika subvencionuese për të ngritur një sistem të organizuar të transportit publik në të gjithë territorin.

Pjesëmarrësit në fokus grupe e ngritën si shqetësim ndriçimin e rrugëve, pasi në shumicën e fshatrave të tre njërive administrative nuk ka fare ndriçim. Linjat janë të shtrira në një pjesë të mirë të territorit por duhen bërë investime për t'i bërë ato funksionale.

## **Pastrimi dhe cilësia**

Pjesëmarrësit janë të pakënaqur me shërbimin e pastrimit. Përveçse në fshatrat Topullaraj, Valare dhe Shen Todher nuk ka kuzanë për hedhjen e mbeturinave në asnjë fshat tjetër të zonës. Grumbullimi i mbeturinave në kuzanët ekzistues behet në mënyrë jo sistematik. Banorët e zonës i hedhin mbetjet në buzë të përrenjve, lumenjve apo edhe në kodrinat përreth duke krijuar nje ndotje të madhe mjedisore, në një kohë që zona kërkon të zhvillojë ekoturizmin. Ata ngritën me shqetësim të madh domosdoshmërinë e disiplinimit të mbetjeve duke kërkuar që bashkia të bëjë një plan ndërhyrjeje për t'i dhënë një zgjidhje tërësore këtij problemi.

## **Uji i pijshëm, kanalizimet, kanalet kulluese**

Lunxhëria është një zonë ujëmbajtëse dhe çdo fshat ka burimin e vet nga i cili furnizohet me ujë me rrjedhje të lirë, por investimet e munguara në sistemin e shpërndarjes e bëjnë këtë zonë që të vuajë ende nga mungesa e ujit. Banorët e njësive administrative u shprehën se ata përballen me problemet e furnizimit me ujë në një pjesë të mirë të territorit ku furnizimi me ujë nuk zgjat më shumë se një orë në ditë, përveçse në shumë pak fshatra ku bëhet furnizimi 24 orë. Duket se rrjeti i shpërndarjes edhe pse ekzistues, është tejet i amortizuar dhe ndërhyrjet e bëra në të si rezultat i rritjes së numrit të banesave kanë krijuar mjaft probleme në furnizimin me ujë. Megjithatë, banorët pohojnë se uji që përdorin është i garantuar dhe i një cilësie shumë të mire.

Përsa i përket kanalizimeve të ujërave të zeza, ka një sistem të tillë vetëm në tre fshatra (Valare, Topullaraj dhe Dhoksat) ku ka të ndërtuara blloqe pallatesh, por këtu mbetet problem shumë i madh derdhja e tyre në lumë, derdhja e tyre në mes të fshatit dhe depozitimi në gropa septike. Pjesëmarrësit pohuan se bashkia, përmes bordit të kullimit ka ndërhyrë me investime gjate këtij viti në sistemin e kanaleve vaditëse në zone. Ndërkohë që nuk është bërë asnjë investim në sistemin e kanaleve kulluese të cilat janë ndërtuar para viteve '90 dhe janë tejet të amortizuara. Nga bashkëbisedimi me banorët e njësive administrative, problematike është edhe situata e pyjeve dhe kullotave. Këto të fundit janë dëmtuar në vite nga erozioni dhe kanë nevojë për investime.

## **8.2.2 Demokracia Lokale - Mirëqeverisja**

### **Informimi dhe komunikimi**

Në përgjithësi, banorët janë të kënaqur nga punonjësit e njësive administrative në lidhje me informimin dhe komunikimin edhe pse mungon një zyrë informacioni dhe burimet njerëzore përkatëse. Ata nuk kanë hasur ndonjë vështirësi në këtë aspekt pasi edhe orientimi nëpër këto zyra është mjaft i thjeshtë dhe punonjësit kanë treguar gjithmonë gatishmëri për t'u shërbyer.

### **Transparenca në vendimmarrje**

Pjesëmarrësit në të tre fokus grupet u shprehën se forma e vetme që njohin për t'u njohur me vendimet e bashkisë është vetë njësia administrative. Përveç këndeve të njoftimeve në ambientet e brendshme të Njësive administrative, këndet e njoftimeve nëpër fshatra janë të vendosura kryesisht në muret e objekteve social-kulturore ose shtyllat e energjisë elektrike.

### **Pjesëmarrja në vendimmarrje**

Edhe pse të vetëdijshëm mbi të drejtën e pjesëmarrjes në vendimmarrje për çështje që lidhen me komunitetin e tyre, banorët e njësisë administrative Lunxhëri thanë se ata nuk ishin njoftuar



ndonjëherë për të qenë pjesë e këtyre takimeve në rang Bashkie. Të vetmet takime (edhe këto të rralla) kanë qenë ato të organizuara nga kryetaret e fshatrave apo administratori i NJA. Kryetarët/et e fshatrave janë përpjekur here pas here të adresojnë ndonjë problem, por ata duhet të jeni më aktive dhe të përfaqësojnë komunitetin e tyre denjësisht. Përsa i përket të drejtës së tyre për të marrë pjesë në mbledhjet e këshillave, pjesa më e madhe e pjesëmarrësve nuk e njihin këtë të drejtë, ndërkohë që asnjëri prej tyre nuk e kishte këtë eksperience.

### **8.2.3 Zhvillimi Ekonomik Vendor**

#### **Planifikimi strategjik**

Ka një mungesë informimi të gjerë në lidhje me ekzistencën por edhe konceptin e planit strategjik për zhvillimin ekonomik dhe akoma më shumë me çfarë parashikon ky plan për secilën prej tre njësive administrative objekt i këtij vlerësimi. Duket se banorët e njësive administrative njihen me planet e zhvillimit ekonomik vetëm gjatë periudhës së fushatës elektorale. Pjesëmarrësit nuk ishin në dijeni të ndonjë strategjie apo politike punësimi. Ata thanë se pjesa më e madhe e banorëve merren me bujqësi dhe blegtori dhe një pjesë e tyre janë vetëpunësuar në zonë apo edhe në biznese private në qytet duke qenë se distanca me qytetin e Gjirokastrës është e vogël.

#### **Nxitja e bizneseve/fermerëve**

Një prej pjesëmarrësve në fokus grupin e zhvilluar në NJA Lunxhëri tha se nuk ka ndier ndonjë lehtësim fiskal në taksat që ajo paguan për biznesin e saj, në një kohë që edhe fuqia blerëse ka rënë në mënyrë të ndjeshme. Në sytë e komunitetit nuk vihet re ndonjë përpjekje për të krijuar ndonjë hapësirë punësimi përmes ndonjë politike nxitëse për të rinjtë apo gratë e kësaj zone.

#### **Mbledhja e të ardhurave dhe planifikimi i buxhetit**

Në të tre fokus grupet pjesëmarrësit janë shprehur se janë në dijeni të detyrimit për taksat vendore, dhe janë shumë të rregullt në pagesën e tyre. Sanksionet vlerësohen pozitivisht si mekanizma disiplinues për qytetarët që shkelin ligjin. Nga ana tjetër, banorët shprehen skeptikë mbi mënyrën si taksat e tyre administrohen, mbi planifikim financiar të bashkisë dhe ndikimin që ky i fundit do të ketë për zonën e tyre.

### **8.2.4 Të Drejtat e njeriut në nivel vendor**

#### **Gratë**

Ka mungesë totale informacioni mbi ndonjë program që trajton çështjet e dhunës gjinore, ekzistencën e organizatave të shoqërisë civile që punojnë në zonë apo mënyrës sesi komuniteti mund të kërkojë ndihmë. Ndërkohë, asnjë prej grave pjesëmarrëse nuk mund të thoshte nëse është organizuar ndonjë fushatë informimi kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe as nëse kishte ndonjë projekt apo program ndërhyrjeje nga ana e bashkisë.

#### **Grupe me nevoja të veçanta**

Pjesëmarrësit nuk kishin informacion mbi ekzistencën e programeve të veçanta për mbështetjen dhe integrimin e grupet me nevoja të veçanta në zonë. Grupet me nevoja të veçanta më së shumti janë mbështetur nga individë apo shoqata të huaja të cilat në mënyrë sporadike kanë

ofruar ushqime, veshmbathje apo edhe mjete shkollore për fëmijët e tyre. Nga ana institucionale këto grupe përveçse ndihmës ekonomike dhe asaj të paaftësisë nuk kanë ndonjë mbështetje tjetër.

### **Romët dhe Egjiptianët**

Banorët e të tre njësive administrative u shprehën se në zonën e tyre nuk ka komunitet Rom dhe Egjiptian.

### **Mbrojtja nga diskriminimi**

Shumica e pjesëmarrësve në tre fokus grupet nuk kishin njohje të mirë mbi ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi. Ata gjithashtu nuk kanë dijeni për ekzistencën e Komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi. Pas prezantimit me konceptin “diskriminim”, banorët u shprehën njëzëri se nuk e kanë hasur ndonjëherë këtë problematikë. Komuniteti vllah është i integruar shumë mirë në shoqëri dhe respektohet nga të gjithë. Megjithatë, ata ranë dakord se informacioni sesi dhe ku diskriminimi mund të adresohet është shumë i nevojshëm.

## **8.3 REKOMANDIME**

Rekomandimet në vijim i referohen problematikave të konstatuara nga komuniteti në të gjithë territorin e Bashkisë:

- Nga vlerësimi i të gjitha takimeve të kryera në katër territore të ndryshme të Bashkisë vihet re niveli i ulët i informimit të komuniteteve mbi aktivitetin e bashkisë. Edhe pjesa që banon në zonën qendrore të saj nuk kishte informim mbi çfarë bën dhe çfarë ka arritur bashkia. Faqja e ueb të Bashkisë Gjirokastrë është e pa përditësuar dhe ka fokus promovimin e vlerave historike, kulturore dhe arkitektonike të qytetit, por jo ndarjen e informacionit mbi aktivitetin e vazhdueshëm të Bashkisë me qytetarët e saj. Gjithashtu, edhe llogaria e Bashkisë Gjirokastrë në rrjetet sociale interaktive si p.sh. Facebook, është prej kohësh e pa përditësuar. Për këtë arsye rekomandojmë që bashkia të hartojë e zbatojë një strategji të mirë komunikimi me qëllim informimin e komuniteteve në të gjithë territorin e saj, si dhe përfshirjen e mendimit të tyre në çështjet me interes për ta.
- Vlerësimi tregoi se në shumë çështje ka diferenca mes shërbimit që ofrohet në zonën urbane me atë në zonën rurale brenda territorit të bashkisë, prandaj autoritetet vendore duhet të analizojnë këto diferenca dhe në planet e tyre t'i adresojnë për t'i eliminuar gradualisht e për të respektuar të drejtën e banorëve për të marrë shërbime të njëjta pavarësisht nga vendbanimi i tyre.
- Rekomandohen ndërhyrje në infrastrukturën e rrugëve dytësore dhe rrugët lidhëse, si në periferinë e qytetit ashtu edhe në zonat rurale. Rekomandojmë që në planifikimin e ndërhyrjeve infrastrukturore të mbahen gjithashtu në konsideratë nevojat për akses dhe lëvizshmëri të grupeve të ndryshme të përdoruesve me nevoja të veçanta (personat me aftësi të kufizuara, karrocet e fëmijëve dhe të moshuarit).
- E nevojshme është ndërhyrja e bashkisë në lidhje me transportin publik mes Njësive Administrative dhe Gjirokastrës qytet.

- Shtrirje e ndriçimit edhe në zonat periferike të qytetit dhe në zonat rurale të saj. Mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit.
- Vëmendje e shtuar kërkohet për pastrimin në zonën periferike të qytetit, fshatrave në njësitë administrative. Shumë e nevojshme është vendosja e koshave/ kazanëve të mbeturinave të aty ku mungojnë totalisht dhe/ose shtimi i atyre ekzistues.
- Shtim i hapësirave të gjelbra dhe çlodhëse në lagjet periferike të qytetit dhe rekomandohet që në këtë çështje të ketë përfshirje të komunitetit në iniciativat e bashkisë për të rritur gjelbërimin.
- Furnizimi me ujë të pijshëm u raportua si problem në të gjitha takimet e zhvilluara me komunitetin dhe duke qenë një çështje tejet e ndjeshme për banorët, rekomandojmë adresimin me prioritet nga bashkia. Gjithashtu, kërkohet me ngut ndërhyrja e bashkisë në zgjidhjen e problemit të kanalizimeve dhe në planifikimin e ndërtimit të rrjetit të ujërave të zeza sidomos në fshatrat shumë të banuara.
- Rekomandohen pastrime të vazhdueshme të kanaleve kulluese
- Njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak duhet të bëhen disa ditë më parë dhe publike. Këshilli bashkiak duhet të ridimensionojë rolin e tij duke u përfshirë në jetën e komunitetit në takime me të shpeshta me ta, nga një anë për të kuptuar më mirë nevojat, prioritetet e komunitetit dhe mënyrën se si bashkia i adreson këto nevoja që kanalizohen në vendimet e këshillit, si dhe nga ana tjetër edhe për të eliminuar indiferentizmin që banorët shfaqin ndaj aktivitetit të këtij këshilli.
- Bashkia duhet t'i kushtojë vëmendje mbledhjes dhe analizës së të dhënave statistikore të cilat në fakt e ndihmojnë për të vlerësuar më mirë prioritetet dhe politikat që duhet të ndërmerren. Në mënyrë të veçantë të dhëna duhet të mblidhen e analizohen në lidhje me punësimin/papunësinë, rastet e dhunës në familje, etj., e në vijim të ndërtojë strategji e plane veprimi që adresojnë boshllëqet në politika apo shërbime për grupe specifike.
- Bashkia duhet të luaj një rol më aktiv në adresimin e dhunës në familje, veçanërisht në zonën rurale, ku vihet re një mungesë totale informacioni. Fushatat e sensibilizimit të ndërmarra bashkë me organizatat e shoqërisë civile janë pozitive, por ato duhet të koordinohen nga bashkia dhe të përfshijnë të gjithë aktorët që janë pjesë e mekanizmit për adresimin e dhunës (bashki, polici, shëndetësi, shërbime sociale etj.) me qëllim që arrijnë ndikimin e duhur. I domosdoshëm që shërbimi për viktimat e dhunës në familje të jetë i shtrirë në të gjithë territorin e Bashkisë, si në zonën urbane, ashtu edhe atë rurale.
- Pjesëmarrësit janë shprehur për një rol të zbehtë dhe në disa raste inekzistent të bashkisë në lidhje me nxitjen e biznesit, si dhe të punësimit të të rinjve dhe grave. Kjo mund të jetë e lidhur edhe me nivelin shumë të ulët të informimit që komuniteti ka në lidhje me rolin e bashkisë në këtë drejtim, por rekomandojmë që si çështje të adresohet me prioritet nga bashkia si pjesë e planeve të saj strategjike.

# RRETH QENDRËS ALEANCA GJINORE PËR ZHVILLIM

E themeluar në vitin 1994, Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (GADC) është një organizatë jo fitimprurëse, jo partiake, me mbi 20 vjet eksperiencë në punë kërkimore, edukim publik, asistencë për zhvillim kapacitetesh, monitorim dhe avokim. GADC promovon zhvillimin demokratik dhe mirëqeverisjen me një fokus të veçantë në çështjet e barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale. GADC është një organizatë lider në Shqipëri dhe në rajon, e mirënjohur për rolin e saj në prezantimin e çështjeve të rëndësishme në lidhje me të drejtat e grave, siç është dhuna me bazë gjinore dhe trafikimi i personave.

GADC është e njohur për zhvillimin e metodologjive të ndryshme për fuqizimin përmes zhvillimit ekonomik të grupeve vulnerabël, avokimit për çështje themelore ligjore e politika të rëndësishme siç janë Ligji “Për dhunën në marrëdhëniet familjare” apo “Ligji kundër diskriminimit”, Barazia Gjinore apo përfaqësimi i grave në politikë e vendim marrje. Prezantimi i çështjeve të buxhetimit gjinor në nivel lokal dhe qendror si dhe përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje janë dy çështje për cilat GADC ka zhvilluar e zbatuar metodologji të veçanta të cilat sollën ndryshime të rëndësishme që adresojnë pabarazitë dhe përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël në Shqipëri.

Që nga fillimi GADC ka zbatuar shumë projekte, të cilat kanë ndikuar në jetët e qindra pjesëmarrësve në aktivitetet e zhvilluara në të gjithë Shqipërinë. GADC ka një historik të gjatë bashkëpunimi të suksesshëm me aktorë të ndryshëm, përfshirë një numër të madh organizatash shqiptare, institucionesh publike në nivel qendror e lokal, rajonal dhe ndërkombëtar, sektorit privat, medias, akademisë etj. Disa nga aktorët kyç partnerë të GADC-së janë UN Women, UNDP, BE, Ambasada e SHBA, USAID, OSBE, Dhoma të Tregtisë, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, bashki të ndryshme etj.

GADC fuqizohet në punën e saj nga rrjeti i gjerë i bashkëpunëtorëve, ekspertëve dhe trajnerëve kombëtarë e ndërkombëtarë me formim të pasur akademik. GADC punon të shpërndajë sa më shumë informacion dhe të kthehet në një platformë për ndarje eksperiencash e njohurie me të gjithë e në të gjithë vendin.



VLERËSIMI I KOMUNITETIT PËR QEVERISJEN

RAPORT BASHKIA GJIROKASTËR